



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2022:077048

Datë: 15.04.2024

Numri i dokumentit: 05575589

**C.nr.325/2022**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-DEGA NË SUHAREKË**, nga Gjyqtari Robert Tunaj, me pjesëmarrjen e bashkëputores profesionale Myrvedete Bekteshi, në çështjen juridike civile të paditësit: A.B.B, me nr.personal: me vendbanim në S, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Av.B.B nga S, ndaj të paditurës K e S, D. K e A, me objekt kontesti kompensimi i shpenzimeve të udhëtimit, me dt.15.04.2024, bie këtë:

**A K T G J Y K I M**  
**Pa shqyrtim kryesor**

- I. APROVOHET** padia dhe kërkesëpadia e paditësit:A.B.B.
- II. DETYROHET** e paditura K e S – D. K e A, që paditësit në emër të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit t’ia paguaj shumat si në vijim:  
Për periudhën **:01.04.2019 deri 01.04.2022** ka **425 ditë** pune

**II.DETYROHET** e paditura K e S – D. K e A, që paditësës në emër të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit prej 70 % të shpenzimeve të biletës vajtje ardhje për periudhën 01.04.2019 deri me 01.04.2022 për 425 ditë pune x 1,60, shumën totale prej **680 Euro**, t’ia paguaj me kamatë ligjore 8 % nga data e parashtrimit të padisë 19.04.2022 e deri te pagesa definitive, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej **125 euro (njëqind e njëzetë e pesë euro)** të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

**III. REFUZHET** pjesa tjetër e kërkesëpadisë për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit deri me datën 01.04.2019 për shkak të parashkrimit.

**A r s y e t i m**

Paditësja A. B. B mësimdhënëse në SHFMU “Bajram Curri” në N, të cilën me autorizim e përfaqson Av. B. B, pranë kësaj Gjykate me datën 19.04.2022 ka parashtruar padi, ndërsa me datë 22.12.2023 ka bërë precizimin e padisë, kundër të paditurës K e S – D. K e A, për pagesën e kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit, sipas Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë dhe Ligji i Punës nr.03/L-212.

E paditura përmes përgjigjes në padi të dt.02.11.2023 ka propozuar gjykatës që ta aprovoj pjesërisht kërkesë padinë e paditësës si të bazuar prej momentit të paraqitjes së padisë deri të

data e cila mbush tre vite, ndërsa pjesën tjetër ta refuzoj për shkak të parashkrimit, duke zbritur nga paditësit ditët për periudhën e parashkruar bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës, i cili thotë:”Të gjitha kërkesat nga marëdhënia e punës në para parashkruhen brenda afatit prej tri(3)vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës.

Gjykata pas vlerësimit të shkresave të lëndës, konkretisht provave materiale të bashkangjitura padisë, e në kuptim të nenit 8 të Ligjit Për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar dhe vlerësuar çdo provë veç e veç dhe të gjithat së bashku dhe ka gjetur se:

**Kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar.**

Në nenin 143 paragrafin 1 të Ligjit të procedurës kontestimore parashihet që: *“Me aktgjykim gjykata vendos mbi kërkesën që ka të bëjë me çështjen kryesore dhe me kërkesat aksesore.*

Ndërsa në nenin 152 të Ligjit të procedurës kontestimore parashihet që: *“Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij.”*

Nga analizimi i përgjigjes në padi rezulton fakti se e paditura nuk i ka kontestuar faktet vendimtare të kërkesëpadisë, me propozim që pjesërisht ta aprovoj padinë dhe kërkesë padinë e paditëses ndërsa propozon që pjesën tjetër të padisë dhe kërkesë padisë ta refuzon pasi që kemi të bëjmë me parashkrim, me ç ‘rast për gjykatën është sajuar e drejta që në këtë çështje juridiko civile vendimmarrja të bëhet pa shqyrtim kryesor, me të vetëm arsye për zbatimin e ekonomizimit të procedurës, parim ky i sanksionuar dhe i urdhëruar për gjykatën për t’u zbatuar konform nenit 10 paragrafit 1 të Ligjit të procedurës kontestimore, siç parasheh: *“Gjykata ka për detyrë të përpiqet që procedura të zhvillohet pa zvarritje dhe me sa më pak shpenzime, si dhe të bëjë të pamundur çdo shpërdorim të së drejtave procedurale që u takojnë palëve sipas këtij ligji.”*

Në nenin 7 paragrafin 1 të Ligjit të procedurës kontestimore parashihet që: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla.”*

I autorizuari i paditëses, me rastin e ngritjes së padisë, për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit, i ka bashkëngjitur padisë vërtetimet lidhur me provimin e fakteve për ditët e punës, të cilat paraqiten si bazë për kërkimin e shumave të papaguara.

Nga shikimi në vërtetim nr.protokollit:53:V,319/V,109/V i lëshuar nga SH.M.F.U’’ Bajram Curri’’ në N-S, vërtetimet e Agjensise se udhëtimit’’Saba Turs SHPK’’, u vërtetuan ditët e punës së paditëses për kompensimin e udhëtimit.dhe qmimi i biletës prej 1 € për një drejtim .

Bazuar në provat e lartcekur, shihet se kërkesa e paditësit gjen mbështetje të plotë në nenin 35 pika 5 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të dt.18.04.2017, ndërmjet SBASHKU-ut dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës, siç parasheh: *Punonjësve arsimorë(anëtarë të SBASHK-ut) që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë u paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban.*

Gjykata vendosi që t’ia falte besimin provave që ka prezantuar paditësja, konkretisht vërtetimeve të lëshuara nga Drejtora e shkollës, pasi të njëjtat janë nxjerr nga një organ që është i pajisur me

autorizime publike, çka për gjykatën kjo provë ka fuqi të saktësisë për atë që konfirmon, bazuar në nenin 329 paragrafit 1 të Ligjit të procedurës kontestimore.

Vendimi mbi aprovimin pjesërisht të kërkesëpadisë, është mbështetur në nenin 35 pika 5 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të dt.18.04.2017, dhe nenin 382 par. 2. Të LMD-së.

Vendimin për refuzim të pjesëshëm të kërkesëpadisë e mori bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës, i cili thotë: *”Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para parashkruhen brenda afatit prej tri(3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës.*

Vendimin mbi shpenzimet procedurale, gjykata e mbështeti në nenin 452.1 të LPK-së.

Gjykata Aktgjykimin e murr në kuptim të nenit 152 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-DEGA NË SUHAREKË,  
C.nr.325/2022 dt.15.04.2024**

**Bashk.profesionale  
Mirvedete Bekteshi**

**Gjyqtari  
Robert Tunaj**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej **7** ditëve pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.